



QËNDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë 2017

RAPORT PUBLIK

MBI

ARRITJET E NXËNËSVE

TIRANË, Dhjetor 2017

1	Hyrje.....	3
1.1	Metodologjia	3
2	Statistika përmbledhëse për PKAB 2017	4
2.1	Statistika Krahasuese PKAB 2016- 2017	5
3	Lënda: Gjuhë Shqipe	6
3.1	Arritjet e nxënësve	6
3.2	Arritjet në nivel kombëtar	7
3.2.1	Arritjet sipas gjinisë	7
3.2.2	Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat	7
3.2.3	Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit	8
3.3	Qëndrueshmëria e arritjeve	9
3.3.1	Qëndrueshmëria e arritjeve sipas urbanizimit qytet/fshat.....	10
3.3.2	Qëndrueshmëria e arritjeve sipas gjinisë	11
3.4	Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës Shqipe	13
3.5	Statistika krahasuese mbi arritjet e nxënësve në Gjuhë Shqipe	18
4	Lënda: Matematikë.....	21
4.1	Arritjet e nxënësve	21
4.2	Arritjet sipas urbanizimit	23
4.3	Arritjet sipas gjinisë	23
4.4	Arritjet sipas sistemit të edukimit	23
4.5	Qëndrueshmëria e arritjeve	24
4.6	Arritjet sipas urbanizimit	26
4.7	Arritjet sipas gjinisë	26
4.8	Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës	29
4.9	Statistika krahasuese mbi arritjet e nxënësve në Matematikë	33
5	Lënda: Gjuhë e Huaj.....	36
5.1	Arritjet e nxënësve	36
5.2	Arritjet sipas urbanizimit	38
5.3	Arritjet sipas gjinisë	38
5.4	Arritjet sipas sistemit të edukimit	38
5.5	Qëndrueshmëria e arritjeve sipas urbanizimit.....	41
5.6	Qëndrueshmëria e arritjeve sipas gjinisë	41
5.7	Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës së Huaj	44
5.8	Statistika krahasuese mbi arritjet e nxënësve në gjuhë të huaj	47
6	Aneks.....	50

1 Hyrje

Matja e arritjeve të nxënësve në përfundim të një niveli arsimor shërben jo vetëm për të pasqyruar funksionimin e sistemit arsimor dhe kontekstin e politikave arsimore aktuale, por edhe për të ndërtuar politika të reja arsimore. Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.

Raporti publik i Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2017 shërben për t'ju siguruar politikëbërësve, përdoruesve dhe publikut informacion për rezultatet e nxënësve dhe për faktorët që ndikojnë në to. Ai synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve të klasës IX.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që, mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel DAR/ZA, por njëkohësisht edhe krahasimin mes DAR/ZA, duke iu referuar edhe arritjeve në nivel kombëtar.

1.1 Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në bazën e të dhënave të krijuar nga QSHA gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2017 (PKAB). Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe gjuhë e huaj.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave janë:

- DAR dhe ZA (së cilës i përket shkolla që ka ndjekur nxënësi),
- shkolla që ka ndjekur nxënësi,
- gjinia e nxënësit,
- lloji i shkollës (publike/private),
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet),
- kalueshmëria në provimet kombëtare të arsimit bazë,
- pikët e fituara në provim nga çdo nxënës,
- notat në provimet kombëtare të arsimit bazë,
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor (për lëndët e provimeve të arsimit bazë).

Treguesit mbi arritjet mesatare të nxënësve në provimet e arsimit bazë 2017 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar,
- në nivel DAR/ZA,
- sipas urbanizimit - fshat/qytet,
- sipas gjinisë - femra/meshkuj,
- sipas llojit të shkollës (publike/private)

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve të nxënësve të vitit shkollor 2016-2017, të cilët morën pjesë në provimet Kombëtare të Arsimit Bazë 2017, sesioni i parë.

Përpunimi i të dhënave u realizua nëpërmjet programit SPSS.

Informacioni statistikor i përfutur nga përpunimi është paraqitur në formë tabelare dhe/ose grafike.

Raporti përmban këta tregues statistikorë:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim,
- Nota mesatare Vjetore - (NV),
- Nota mesatare e provimit- (NP),
- Shmangia standarde - (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*),
- Nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar - (NVk),
- Nota mesatare e provimit në nivel kombëtar - (NPk),
- Kalueshmëria në provimin e Arsimit Bazë,
- Diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar - (NV – NVk),
- Diferenca e Notës së provimit me Notën e provimit në nivel kombëtar - (NP – NPk),

2 Statistika përmbledhëse për PKAB 2017

Tabela e mëposhtme, paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për pjesëmarrjen në provimet e PKAB-së 2017, sesionin e parë. Të dhënat janë paraqitur sipas kategorive publik/privat, fshat/qytet, femra/meshkuj.

Tabela 2-1: Të dhëna përmbledhëse për pjesëmarrjen në provimet e PKAB-së 2017

Nr .	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provimin e Arsimit Bazë		
		Total	Publik	Privat
1	Gjuhë shqipe	35541	33717	1824
	Qytet	19244	17506	1738
	Fshat	16297	16211	86
2	Matematikë	36522	34634	1888
	Qytet	19609	17813	1796
	Fshat	16913	16821	92
3	Gjuhë e Huaj	29330	27630	1700
	Qytet	17163	15522	1641
	Fshat	12167	12108	59

Nr .	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provimin e Arsimit Bazë		
		Total	Publik	Privat
1	Gjuhë shqipe	35541	33717	1824
	Femra	14425	13694	731
	Meshkuj	21116	20023	1093
2	Matematikë	36522	34634	1888
	Femra	17279	16329	950
	Meshkuj	19243	18305	938
3	Gjuhë e Huaj	29330	27630	1700
	Femra	14364	13504	860
	Meshkuj	14966	14126	840

2.1 Statistika Krahasese PKAB 2016- 2017

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna statistikore përmblledhëse për pjesëmarrjen dhe kalueshmërinë në PKAB 2016 dhe PKAB 2017.

Tabela 2-2: Të dhëna statistikore përmblledhëse për PKAB 2016 dhe PKAB 2017

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në PKAB
		Total	Publik	Privat	(në %)	
PKAB 2017						
1	Gjuhë shqipe	35541	33717	1824	99.50%	7.32
2	Matematikë	36522	34634	1888	98.90%	6.62
3	Gjuhë e Huaj	29330	27630	1700	99.50%	8.22
Të gjitha lëndët		101393	95981	5412	99.2%	7.39
PKAB 2016						
1	Gjuhë shqipe	39176	34475	4701	98.90%	7.24
2	Matematikë	43987	40908	3079	97.60%	6.78
3	Gjuhë e Huaj	34921	32127	29557	99.40%	7.86
Të gjitha lëndët		118084	107510	37337	98.53 %	7.26


Nga krahasimi i të dhënave me PKAB-në e vitit të kaluar, në sesionin e parë për të gjitha lëndët rezultoi se:

- kalueshmëria në provim, është me një rritje prej 0.67%,
- nota mesatare në provimin arsimi bazë, është me një rritje prej 0.13 njësi note.

3 Lënda: Gjuhë Shqipe

3.1 Arritjet e nxënësve

Në grafikun 3-1, janë paraqitur për çdo DAR/ZA, arritjet e nxënësve në provimin kombëtar të arsimit bazë Gjuhë Shqipe.



Grafiku 3-1: Arritjet e nxënësve në provimin kombëtar të arsimit bazë, lënda Gjuhë Shqipe.

3.2 Arritjet në nivel kombëtar

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e Gjuhës Shqipe është **28.31 pikë**, me shmangie mesatare 9.77;
- **nota mesatare e provimit** është 7.31 me shmangie mesatare 1.37;
- **nota mesatare vjetore** është 7.20 me shmangie mesatare 1.71.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të arsimit bazë , referuar po nivelit kombëtar, rezulton se nota mesatare e provimit është 0.11 njësi notë më e lartë se nota mesatare vjetore.

Tabela 3-1 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës Shqipe. Arritjet e nxënësve janë dhënë në nivel kombëtar, sipas urbanizimit fshat/qytet, sipas gjinisë femra/meshkuj, si edhe sipas sistemit publik/privat të edukimit.

3.2.1 Arritjet sipas gjinisë

Duke krahasuar arritjet mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, gjejmë se:

- arritjet mesatare për vajzat janë më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve.
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth **4.48 pikë** më e lartë krahasuar me mesataren e pikëve të fituara nga djemtë.
- nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve në provimet kombëtare, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se arritjet e vajzave në provimet kombëtare janë 0.12 njësi note më të ulëta se arritjet e tyre vjetore. Ndërkohe që për djemtë nuk mund të themi të njëjtën gjë.

3.2.2 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse do të analizojmë arritjet e nxënësve, në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat, rezulton se:

- Ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat.
- Mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth **4.08 pikë më e lartë** ndaj nxënësve të fshatit.
- Ekzistenca e diferencës prej **4.08 pikësh** në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën e notës mesatare të arsimit bazë që ekziston mes dy kategorive, vlera e të cilës është me **0.55 njësi** notë.

Në nivel kombëtar, diferencat më të mëdha ekzistojnë mes djemve që kanë ndjekur shkollën në qytet në krahasim me djemtë që e kanë ndjekur shkollën në fshat, kjo diferencë shkon deri në **4.62 pikë**.

- Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, vajzat e qytetit kanë një notë mesatare me një vlerë prej **0.33** më të lartë se vajzat e fshatit. Kjo diferencë, arrin deri në **0.44** njësi note nëse i referohemi arritjeve në provimin e arsimit bazë.

- Të njëjtën situatë kemi kur krahasojmë arritjet mesatare vjetore me arritjet mesatare të provimeve të arsimit bazë për djemtë e qytetit kundrejt djemve të fshatit.

3.2.3 Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit

Diferenca të mëdha ekzistojnë edhe mes dy sistemeve arsimore (publik/privat) që janë në vendin tonë. Nga të dhënat e tabelës 3-1 rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik.
- kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të provimit dhe atë vjetore.
- të njëjtat dallime ekzistojnë edhe nëse krahasojmë arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin privat me arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin publik, si edhe për kategoritë fshat/qytet në privat kundrejt kategorive fshat/qytet në sistemin publik.

Tabela 3-1: Arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas urbanizimit fshat/qytet, sipas gjinisë femra/meshkuj, si edhe sipas sistemit publik/privat të edukimit

Urbanizimi		Pikët e fituara në Test		Nota e PKAB-së		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	Femra	30.97	9.36	7.67	1.31	7.79	1.61
	Meshkuj	26.49	9.62	7.06	1.35	6.80	1.65
	Total	28.31	9.77	7.31	1.37	7.20	1.71
Qytet	Femra	32.51	9.58	7.88	1.35	7.94	1.65
	Meshkuj	28.60	9.89	7.35	1.39	7.02	1.73
	Total	30.18	9.96	7.56	1.40	7.39	1.76
Fshat	Femra	29.17	8.75	7.44	1.22	7.61	1.54
	Meshkuj	23.98	8.65	6.72	1.23	6.53	1.51
	Total	26.10	9.05	7.01	1.27	6.97	1.61
Publik	Femra	30.97	9.36	7.67	1.31	7.79	1.61
	Meshkuj	26.49	9.62	7.06	1.35	6.80	1.65
	Total	28.31	9.77	7.31	1.37	7.20	1.71
Publik/Qytet	Femra	32.19	9.61	7.83	1.35	7.87	1.66
	Meshkuj	28.10	9.88	7.28	1.39	6.92	1.72
	Total	29.76	9.97	7.50	1.40	7.31	1.76
Publik/Fshat	Femra	29.14	8.74	7.43	1.21	7.61	1.54
	Meshkuj	23.95	8.62	6.72	1.23	6.53	1.50
	Total	26.06	9.04	7.01	1.27	6.97	1.61
Privat	Femra	35.76	8.61	8.31	1.22	8.63	1.39
	Meshkuj	33.53	8.73	8.04	1.22	8.00	1.58
	Total	34.42	8.75	8.15	1.23	8.25	1.54
Privat/Qytet	Femra	35.83	8.61	8.32	1.22	8.64	1.40
	Meshkuj	33.61	8.62	8.04	1.21	8.00	1.58
	Total	34.49	8.68	8.15	1.22	8.25	1.54
Privat/Fshat	Femra	34.67	8.58	8.21	1.18	8.48	1.23
	Meshkuj	31.61	10.99	7.86	1.52	8.00	1.56
	Total	33.10	9.95	8.03	1.37	8.23	1.42

4 Lënda: Matematikë

4.1 Arritjet e nxënësve

Tabela 4-1 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.




Tabela 4-1: Arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës

		Pikët e fituara në test		Nota e provimit të arsimit bazë		Nota Vjetore	
Urbanizimi	Gjinia	Mesatarja	Gabim	Nota	Gabim	Nota	Gabim
		e pikëve	standart	mesatare	standart	mesatare	standart
	Femra	25.28	0.08	6.90	0.01	7.13	0.01
Në nivel kombëtar	Meshkuj	21.38	0.07	6.35	0.01	6.27	0.01
	Total	23.22	0.05	6.61	0.01	6.68	0.01
	Femra	28.03	0.11	7.28	0.02	7.38	0.02
Qytet	Meshkuj	23.98	0.10	6.71	0.01	6.53	0.02
	Total	25.90	0.07	6.98	0.01	6.93	0.01
	Femra	22.09	0.10	6.46	0.01	6.84	0.02
Fshat	Meshkuj	18.36	0.08	5.92	0.01	5.97	0.01
	Total	20.13	0.07	6.18	0.01	6.38	0.01
	Femra	24.86	0.08	6.84	0.01	7.08	0.01
Publik	Meshkuj	20.94	0.07	6.28	0.01	6.20	0.01
	Total	22.79	0.05	6.55	0.01	6.62	0.01
	Femra	27.55	0.12	7.21	0.02	7.31	0.02
Qytet	Meshkuj	23.41	0.10	6.63	0.01	6.43	0.02
	Total	25.36	0.08	6.90	0.01	6.84	0.01
	Femra	22.03	0.10	6.45	0.01	6.83	0.02
Fshat	Meshkuj	18.30	0.08	5.92	0.01	5.97	0.01
	Total	20.06	0.06	6.17	0.01	6.38	0.01
	Femra	32.58	0.32	7.90	0.04	8.08	0.05
Privat	Meshkuj	29.91	0.33	7.53	0.05	7.59	0.06
	Total	31.25	0.23	7.72	0.03	7.84	0.04
	Femra	32.51	0.33	7.90	0.05	8.09	0.05
Qytet	Meshkuj	29.95	0.33	7.54	0.05	7.63	0.06
	Total	31.24	0.24	7.72	0.03	7.86	0.04
	Femra	33.79	1.66	8.04	0.22	7.83	0.24
Fshat	Meshkuj	29.00	1.92	7.44	0.26	6.91	0.27
	Total	31.45	1.28	7.75	0.17	7.38	0.19

Në nivel kombëtar:

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e arsimit bazë në lëndën e Matematikës është **23.22 pikë**, me gabim standart 0.05;
- **nota mesatare e arsimit bazë** është 6.61 me gabim standart 0.01;
- **nota mesatare vjetore** është 6.68 me gabim standart 0.01.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore, me notën mesatare të provimit të arsimit bazë, rezulton se ndryshueshmëria është me 0.07 njësi note.

Rezultatet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë pak më të ulta krahasuar me arritjet vjetore të tyre. Kjo gjetje qëndron për të gjitha kategoritë që janë paraqitur në tabelën 4-1.

5 Lënda: Gjuhë e Huaj

5.1 Arritjet e nxënësve

Në tabelën 5-1 jepet informacion mbi arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës së Huaj në nivel kombëtar. Arritjet e nxënësve në këtë lëndë janë paraqitur në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat të edukimit**.

Tabela 5-1: Arritjet mesatare në lëndën e Gjuhës së Huaj


Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota PKAB		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Total	Femra	31.29	13.69	7.70	1.96	7.79	1.73
	Meshkuj	25.06	12.86	6.80	1.86	6.64	1.73
	Total	28.10	13.63	7.24	1.96	7.20	1.82
Qytet	Femra	34.40	13.90	8.12	1.98	8.12	1.71
	Meshkuj	27.64	14.07	7.16	2.03	6.98	1.82
	Total	30.91	14.39	7.63	2.06	7.54	1.86
Fshat	Femra	27.11	12.21	7.12	1.78	7.35	1.66
	Meshkuj	21.47	9.89	6.31	1.47	6.15	1.46
	Total	24.24	11.45	6.71	1.68	6.74	1.67
Publik total	Femra	30.69	13.57	7.61	1.95	7.73	1.73
	Meshkuj	24.44	12.49	6.72	1.81	6.55	1.69
	Total	27.48	13.40	7.15	1.93	7.12	1.81
Qytet	Femra	33.64	13.93	8.02	1.99	8.04	1.72
	Meshkuj	26.80	13.77	7.04	1.99	6.87	1.80
	Total	30.10	14.26	7.51	2.05	7.43	1.86
Fshat	Femra	27.05	12.17	7.12	1.78	7.34	1.66
	Meshkuj	21.41	9.83	6.30	1.46	6.15	1.45
	Total	24.19	11.40	6.70	1.67	6.74	1.67
Privat total	Femra	42.37	10.87	9.20	1.53	8.96	1.30
	Meshkuj	37.25	13.98	8.50	2.00	8.34	1.52
	Total	39.82	12.77	8.85	1.81	8.65	1.45
Qytet	Femra	42.32	10.89	9.20	1.53	8.96	1.30
	Meshkuj	37.35	13.91	8.52	1.99	8.34	1.52
	Total	39.86	12.72	8.86	1.81	8.66	1.45
Fshat	Femra	44.23	10.10	9.35	1.41	8.85	1.29
	Meshkuj	34.61	15.74	8.06	2.26	8.12	1.58
	Total	38.85	14.28	8.63	2.02	8.44	1.49

Në nivel kombëtar kemi:

- Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Gjuhës së Huaj është **28.10 pikë** me shmangie mesatare 13.63,
- Nota mesatare e provimit të gjuhës së huaj të arsimit bazë është **7.24**, me shmangie mesatare 1.96,
- Nota mesatare vjetore **7.20** me shmangie mesatare prej 1.82.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të PKAB, referuar po nivelit kombëtar, rezulton se arritjet e nxënësve në provimin PKAB janë më të larta krahasuar me arritjet vjetore, me rreth (0.04) njësi note.

Grafiku 5-1 paraqet të dhëna krahasuese, në nivel DAR/ZA, të arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë. Në grafik jepen mesataret e pikëve të secilës DAR/ZA duke i krahasuar ato me mesataren e pikëve në nivel kombëtar.



Grafiku 5-1